

VENDIM
Nr.39, datë 5.5.2010

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “SELCA ENERGJI” SHPK

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa “a”, 9 dhe 13 pika 1, germa “a” të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “a”, neni 5 pika 1 germa “a” dhe neni 17 pika 2 germa “a” dhe “d” të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë(ERE), në mbledhjen e tij të datës 5.05.2010, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Selca Energji” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

“HEC Selce”, bazuar në vendimin nr.5, datë 20.01.2010 të Bordit të Komisionerëve i është dhënë në operim WTS Energji sh.p.k. deri në licencimin e personit në pronësi të të cilit është ky HEC.

Me vendimin nr.13, datë 8.02.2010 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s kanë filluar procedurat për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të shoqërisë “Selca Energji” sh.p.k., e cila ka në pronësi Hec Selcen.

Aplikimi i shoqërisë “Selca Energji” sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licencave, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, germa “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte. (Neni 17 pika 2 germa “a”)

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germa “a”, “b”, “c”, “d”, “f” dhe “g”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte. (Neni 17 pika 2 germa “b”)

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germa “a”, “b” dhe “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte. (Neni 17 pika 2 germa “c”)

- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4) është plotësuar në mënyrë korrekte dhe nuk ka asnjë ndryshim apo modifikim të tij. (Neni 17 pika 2 germa “d”).

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë “Selca Energji” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC Selce.

2. Afati i vlefshmërisë së licencës të jetë 30 vjet.

3. Shoqëria “Selca Energji” sh.p.k., të fillojë ushtrimin e aktivitetit me hyrjen në fuqi të këtij vendimi.

4. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta